

# A ishte Jezusi i Krishter apo Mysliman?

Përgaditur nga: Abo Kareem El-Marakshy
Përktheu: Vullnet Mehmeti

# A ishte Jezusi i Krishter apo Mysliman?

Përgaditur nga: Abo Kareem El-Marakshy

Përktheu: Vullnet Mehmeti

## Përmbajtja


| | |
|---|---|
| Hyrje | 3 |
| Parathënie | 4 |
| 1- Pastërtia, Abdesi para faljes së namazit | 5 |
| 2- Heqja e këpucëve para hyrjes në namaz | 6 |
| 3- Kohët e caktuara për namazet e përditshme | 7 |
| 4- Namazi drejt një drejtimi të caktuar (Kibla) | 8 |
| 5- Gjunjëzimi, rënia në sexhde me ballin mbi tokë | 9 |
| 6- Ngritja e duarve pas namazit | 10 |
| 7- Agjërimi | 11 |
| 8- I Dërguar dhe Profet i Zotit | 12 |
| 9- Nënshtrimi ndaj vullnetit të Zotit të Plotfuqishëm (Islam) | 14 |
| 10- Emri i Zotit të Plotfuqishëm | 15 |
| 11- Monoteizmi | 17 |
| 12- Bijtë e Zotit (Perëndisë) | 19 |
| 13- Shpëtimi & Shpëtimtari | 20 |
| 14- Dituria absolute (Gjithëdijenia) | 21 |
| 15- Mrekullitë (mu'xhizet) | 22 |
| 16- Përshëndetjet | 23 |
| 17- Pijet alkoolike | 24 |
| 18- Mishi i derrit | 25 |
| 19- Therja e kafshëve | 26 |
| 20- Ngrënia e mishit me gjak | 28 |
| 21- Gratë e mbuluara me perçe (vello) | 29 |
| 22- Pastërtia, Larja e tërë trupit | 30 |
| 23- Poligamia | 32 |
| 24- Përkulja para idhujve, figurave të gdhendura, statujave & kryqeve | 33 |
| 25- Tradhëtia bashkëshortore | 35 |
| 26- Pastërtia, Synetimi | 36 |
| 27- Fajdeja (kamata) | 37 |
| 28- Mjekra dhe veshja (rrobat) | 38 |
| 29- Muhammedi është i paralajmëruar në Dhjatën e Vjetër | 39 |
| 30- Myslimanët të përmendur në Bibël | 40 |
| Konkluzioni | 41 |
| Referencat | 42 |

## Hyrje

Duhet të pyesësh veten pyetjen në vijim:

1- A jam unë ndjekës i vërtetë i Jezu Krishtit?
2- A jam duke e kërkuar me seriozitet të vërtetën apo vallë mos jam armiku i të vërtetës?
3- A ishte Jezu Krishti i krishterë apo mysliman?

Ky libër është për të gjithë krishterët të cilët e kërkojnë të vërtetën me sinqeritet dhe ndershmëri.

Unë jam përpjekur të pajisem me informacione të konsoliduara prej librave burimor dhe faqeve të internetit, duke i vendosur këto informacione në tablo krahasuese të përmbledhura shkurtimisht në një mënyrë të drejtë dhe të avancuar.

Unë e apeloj lexuesin që ta kontrollojë këtë libër me një intelekt të paanshëm dhe me zemër të hapur për të vërtetën sepse kjo është e vetmja mënyrë e cila të shpien drejt vendimit të drejtë që ia rregullon njeriut jetën e kësaj dhe të asaj bote.

## Parathënie

| | |
|---|---|
| Emri "Krisht" ka prejardhje nga gjuha e vjetër greke: Χριστός - Khristós, që do të thotë 'i lyer me vaj (i vajosur)', që është përkthim i fjalës në hebraisht מָשִׁיחַ (Māšîaḥ), Mesia, e që përdoret si emër i Jezusit. | "Islam" do të thotë nënshtrim absolute, i plotë dhe paqësor ndaj vullnetit të Zotit të Plotfuqishëm. |
| Fjala "Krishter" thjeshtë do të thotë "Ndjekës i Krishtit" apo "Christ-ian" | Fjala "Mysliman" thjeshtë do të thotë personi i cili e nënshtron vullnetin e tij ndaj Zotit të Plotfuqishëm. |

Jezusi (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) ka thënë:

| | |
|---|---|
| "Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar ligjin ose profetët; unë nuk erdha për t`i shfuqizuar, po për t`i plotësuar. Sepse në të vërtetë ju them: Deri sa qielli dhe toka, të kalojnë asnjë jotë a asnjë pikë e ligjit nuk do të kalojnë, para se të plotësohet gjithçka." (Mateu 5:17-18). | "Pastaj u tha atyre: ``Këto janë fjalët që unë ju thoja kur isha ende me ju: se duhet të përmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar lidhur me mua në ligjin e Moisiut, në profetët dhe në psalmet``." (Luka 24:44). |

Jezusi a.s. nuk ka patur autorizim që të shfuqizojë ligjin. Ai a.s. ishte i autorizuar vetëm për ta përmbushur, riafirmuar, qartësuar dhe për ta aplikuar atë në situata të reja apo specifike.

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 1- Pastërtia, Abdesi para faljes së namazit<br>  | Moisiu (Musai) a.s. dhe Aroni (Haruni) a.s. kanë marrë abdes përpara namazit, ata i kanë larë <u>duart</u> dhe <u>këmbët</u> sa herë që ata kanë hyrë në çadrën e tubimit apo altar që i drejtohen për lutje. Ky ishte <u>urdhër</u> <u>Hyjnor</u>: (Eksodi 40:31-32). Davidi (Davudi) a.s.: (Psalmet 26:6), (2 i Samuelit 12:20).<br>Jezusi (Isai) a.s. nuk e ka kundërshtuar abdesin përpara lutjes. Kjo përmendet në (Jakobi 4:8): “Afrohuni te Perëndia dhe ai do t`ju afrohet juve; <u>pastroni</u> <u>duart</u> tuaja, o mëkatarë; dhe <u>pastroni</u> <u>zemrat</u> o njerëz me dy mendje!<br>Jezusi a.s. e ka ndjekur me kujdes dhe e ka <u>përmbushur</u> këtë ligj, sepse ky ishte një <u>urdhër Hyjnor</u>. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët <u>nuk</u> marrin abdes (pastrim) <u>përpara</u> lutjen në kishat e tyre.<br><br>Krishterët nuk i lajnë <u>duart</u> dhe <u>këmbët</u> <u>përpara</u> se të luten siç janë të urdhëruar nga Zoti i Plotfuqishëm.<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin që është <u>i përmbushur</u> nga Jezusi a.s. | Myslimanët marrin abdes para se të luten në xhamitë e tyre, myslimanët lajnë duart, këmbët, fytyrën…etj. Kur’ani Fisnik (5:6).<br>Uthman ibn Affani (Allahu qoftë I kënaqur me të) ka deklaruar se profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Ai i cili merr abdes në mënyrën më të mirë i bien mëkatet nga trupi madje do t’i dalin edhe nga nën thonjtë e tij.” (Sahih Muslim) |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 2- Heqja e këpucëve para hyrjes në namaz  | Moisiu a.s. mori urdhërin Hyjnor për t'i hequr sandalet (këpucët) e tij përpara se të hyjë dhe të lutet në tokën e shenjtë: (Eksodi 3:5) dhe (Veprat 7:33).<br><br>Jezusi a.s. e ka ndjekur me kujdes dhe e ka përmbushur këtë ligj, sepse ky ishte një urdhër Hyjnor. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët nuk i heqin këpucët e tyre përpara se të hyjnë dhe të luten (falen) në kishat e tyre. Të krishterët nuk e ndjekin ligjin që është i përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët i heqin këpucët e tyre përpara se hyjnë dhe falin (namaz) në xhamitë e tyre.<br>Kur'ani Fisnik (20:11-12). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 3- Kohët e caktuara për namazet e përditshme  | Kohët biblike për lutje (falje) janë: Mbrëmja, mëngjesi dhe mesdita: (Psalmet 55:17), madje edhe disa lutje mund të gjenden Brenda këtyre tri kohëve. Citohet në (Psalmet 119:164): “Të lëvdoj shtatë herë në ditë…” Lutja herët në agimin e mëngjesit është përmendur në Biblën Aramaike në Anglishten e rëndomtë: (Psalmet 5:3), përpara faljes në agimin e mëngjesit: (Psalmet 119:147).. Lutja në mesnatë: (Psalmet 119:62). Ka kohë të caktuara për lutje: (Psalme 32:6), (Psalme 69:13). Ishte siç duket e papranueshme, sipas Davidit (Davudit) a.s. që të lihen pas dore kohët e duhura të lutjes. <br><br> Jezusi a.s. e ka ndjekur me kujdes dhe e ka përmbushur këtë ligj. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Shumë të krishterë zbatojnë një model tepër informal të lutjes së mëngjesit dhe mbrëmjes, bekim apo lutje përpara ngrënies, këtij lloj të informalitetit i mungon saktësia (në kohë) dhe përsëritja. <br><br> Të krishterët nuk e ndjekin ligjin që është i përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët duhet rregullisht të luten (falin namaz) pesë herë në ditët në kohë të sakta (të caktuara), çdo namaz kërkon rreth 5 deri në 10 minuta. Këto pesë namaze përsëriten në kohë të caktuara: 1. Në agim të mëngjesit, 2. Në pasditë, 3. Më vonë pasdite, 4. Pas perëndimit të diellit, 5. Natën. Ka edhe namaze tjera jo të detyrueshme. <br> Kur’ani Fisnik: (20:132), (7:205), (33:42), (48:9), (76:25), (24:58), (52:49), (17:78), (11:114), (20:130). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 4- Namazi drejt një drejtimi të caktuar (Kibla)<br><br>**Jeruzalem**<br><br><br>**Qabja në Mekë**<br> | Davidi a.s. e ka adhuruar Zotin e Plotfuqishëm në drejtim të tempullit të shenjtë: (Psalmet 5:7), (Psalmet 138:2), sipas Interpretimit të Gill-it të tërë Biblës "<u>jo</u> që ishte tempulli në Jeruzalem, i cili <u>nuk ishte ndërtuar akoma</u>… por përkundrazi <u>tabernakulli (faltorja) e Moisiut</u>, në të cilin ishte arka", megjithatë tabernakulli i Moisiut <u>nuk ishte</u> një tempull i shenjtë! Atëherë pyetje është: Cili ishte tempulli tjetër i shenjtë kah i cili drejtohej Davudi a.s. në lutje?! Solomoni (Sulejmani) a.s. lutej në drejtim të tempullit të shenjtë në Jeruzalem: (2 i Kronikave 6:21), Danieli a.s.: (Danieli 6:10), Jona a.s. (Jona 2:7).<br>Në kohën e Jezusit a.s. drejtimi i lutjeve ishte kah Jeruzalemi: (Gjoni 4:20-21). Jezusi a.s. ka thënë se adhuruesit e vërtetë do ta adhurojnë Zotin (Perëndinë) në "frymë dhe në të vërtetën": (Gjoni 4:23-24), që do të thotë se "ata do të jenë <u>të sinqertë</u> në adhurimin e tyre", kjo nuk do të thotë se ata do ta adhurojnë Perëndinë në çdo drejtim. Jezusi a.s. i ka ndjekur me kujdes profetët e mëparshëm dhe është lutur në drejtim të tempullit të shenjtë. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Kishat e mëhershme kanë qenë të ndërtuara në atë mënyrë që drejtimi i asamblesë të jetë me pamje nga <u>Lindja</u>, si simbol i Krishtit (dielli në lindje). Ishte gjithashtu e zakonshme të luturit në drejtim të Jeruzalemit.<br>Të krishterët e mëvonshëm janë lutur në <u>cilindo</u> drejtim.<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin Jezusin a.s. dhe nuk luten në një drejtim të caktuar. | Muslimanët e mëhershëm janë falur në drejtim të <u>Jeruzalemit</u> për një kohë të shkurtër, e pastaj Zoti i Plotfuqishëm (Allahu) e ka urdhëruar Profetin Muhamed a.s. që ta ndërrojë drejtimin e faljes (së namazit) dhe të falet në drejtim të xhamisë së shenjtë (Qabes) në Mekë.<br>Kur'ani Fisnik: (2:144). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 5- Gjunjëzimi, rënia në sexhde me ballin mbi tokë  | Profetët e mëparshëm dhe pasuesit e tyre gjunjëzoheshin (bienin në sexhde) në namaz, ata përkuleshin me fytyrat e tyre duke ra për toke, Abrahami (Ibrahimi) a.s.: (Zanafilla 17:3), (Zanafilla 17:17), Moisiu (Musa) a.s. dhe Aroni (Haruni) a.s.: (Eksodi 34:8), (Numrat 16:22), (Numrat 20:6), Jozueu a.s.: (Jozueu 5:14), (Jozueu 7:6), Elia a.s.: (1 i Mbretërve 18:42), Davidi (Davudi) a.s.: (Psalmet 22:29), (1 i Samuelit 20:41), e më pas Solomoni (Sulejmani) a.s. e përfundoi lutjen: (2 i Kronikave 7:3), gjatë lutjes së Ezdras a.s.: (Nehemia 8:6), Engjëjt e Shenjtë: (Zbulesa 7:11).<br>Jezu Krishti (Isai) a.s. kurrë nuk i ka ftuar njerëzit që ta adhruojnë atë në vend të Zotit (Perëndisë), apo si Zoti, apo si biri i Zotit. Ky ligj është cituar shumë qartë në (Numrat 23:19): “Perëndia nuk është një njeri, që mund të gënjejë, as edhe bir njeriu që mund të pendohet…”. Perëndia nuk është një njeri: (1 i Samuelit 15:29), (Osea 11:9). Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj dhe është përkulur me fytyrën e tij për toke dhe i është lutur Zotit të Plotfuqishëm: (Mateu 26:39), (Marku 14:35), madje edhe dishepujt e Jezusit a.s. e bënë të njëjtën gjë: (Mateu 17:6). |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët gjunjëzohen përpara kryqit, i mbërthejnë (shtrëngojnë) duart e tyre në lutje, ata bëjnë shenjën e kryqit duke formuar një kryq të madh nga balli në kraharor e pastaj nga njëri sup në tjetrin, ky veprim nuk mund t’i atribuohet Jezusit a.s.<br>Të krishterët nuk përkulen me fytyrat e tyre për toke, ata nuk bëjnë sexhde, duke rënë me ballin e tyre në tokë. Të krishterët nuk e ndjekin të njëjtën mënyrë të adhurimit të Jezusit a.s. | Myslimanët gjunjezohen dhe bëjnë sexhde në namaz, ata përkulen me fytyrat e tyre duke prekur me ballin në tokë gjatë lutjeve (namazeve) të tyre të përditshme.<br>Kur’ani Fisnik: (22:77), (7:206), (13:015), (17:109), (19:058), (25:060), (96:019), (32:015), (38:024), (53:062), (76:026), (10:9-10). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 6- Ngritja e duarve pas namazit  | Solomoni a.s. i ka ngritur duart pas namazit, e ka lavdëruar Zotin e Plotfuqishëm dhe I ka kërkuar bekimet e Tij: (1 i Mbretërve 8:54).<br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë praktikë. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët nuk i ngrenë duart e tyre pas lutjes. Të krishterët nuk nuk e ndjekin praktikën që e ka përmbushur Jezusi a.s. | Myslimanët i ngrenë duart e tyre pas namazit, ata e lavdërojnë Zotin e Plotfuqishëm, kërkojnë falje prej Tij dhe kërkojnë bekimet eTij. Kur’ani Fisnik: (2:255, 286), (25:74). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 7- Agjërimi   | Moisiu (Musa) a.s. ka agjëruar dyzet ditë pa hëngër dhe pa pirë, as që ka hëngër bukë e as që ka pirë ujë: (Ligji i Përtërirë 9:9), (Eksodi 34:28). Profetët e mëparshëm gjithashtu kanë agjëruar, Davidi (Davudi) a.s.: (2 i Samuelit 12:22), Elia a.s.: (1 i Mbretërve 19:8), Ezdra a.s.: (Esdra 10:6), Danieli a.s.: (Danieli 9:3).<br>Muajt e posaçëm të agjërimit janë bërë zakon gjatë robërisë babiloanse të Judës: (Zakaria 8:19). Një ditë e veçantë e agjërimit: (Jeremia 36:6). Një muaj i caktuar për të agjëruar (muaji i nëntë): (Jeremia 36:9).<br>Jezu Krishti (Isai) a.s. e ka përmbushur këtë ligj dhe ka agjëruar dyzet ditë duke mos ngrënë dhe duke mos pirë, më pas Jezusi a.s. ishte i uritur: (Mateu 4:2), (Mateu 6:16), (Mateu 17:21).<br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Mënyra e agjërimit të krishterëve ndryshon, disa të krishterë u përmbahen (heqin dorë) nga ushqimet e forta, të tjerët nuk hanë ushqime të veçanta si (mish, peshk, mish pule dhe vezë), disa të tjerë nuk pijnë pije të veçanta si (qumësht dhe verë).<br><br>Të krishterët nuk agjërojnë si Jezusi (Isai) a.s., pa ngrënë dhe pa pirë për një periudhë të caktuar kohe, ata nuk e shijojnë urinë dhe etjen.<br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët agjërojnë nga agimi i mëngjesit deri në muzgun e ditës gjatë tërë Ramazanit (muaji i nëntë hënor), duke u përmbajtur nga ushqimi, pija, marrëdhëniet seksuale, pirja e duhanit, përgojimi, gënjeshtra dhe disa kënaqësi të tjera. Myslimanët e shijojnë urinë dhe etjen, agjërimi u ndihmon atyre që t'i binden Zotit, të jenë më të ndjeshëm ndaj vuajtjeve të të tjerëve, të zhvillojnë vetëdisiplinim dhe të çmojnë unitetin e tyre. Kur'ani Fisnik: (2:183-185, 187, 196). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 8- I Dërguar dhe Profet i Zotit<br> | Jezusi a.s. ka pohuar se ai është dërguar nga Zoti (Perëndia), d.m.th. një i dërguar i Zotit të Plotfuqishëm: (Gjoni 7:16), (Gjoni 17:3), (Gjoni 5:30), (Gjoni 4:34), (Gjoni 6:38) dhe (Gjoni 11:41-42). Jezusi a.s. i referohet vetes si një profet: (Luka 13:33-34), të tjerët gjithashtu e quajtën një profet: (Luka 7:16), (Luka 24:17-22), (Gjoni 4:19), (Gjoni 6:14), (Mateu 21:11), (Gjoni 9:17). Jezusi a.s. është i përmendur si një shërbëtor i Perëndisë: (Veprat 3:13), (Veprat 4:27). Jezusi a.s. ka qenë i dërguar vetëm për "delet e humbura të shtëpisë së Izraelit dhe të johebrenjve".: (Mateu 10:5-6), (Mateu 15:24-27). Jezusi a.s. është quajtur "Biri i njeriut": (Mateu 12:32), (Mateu 12:40), (Mateu 17:9), (Gjoni 6:27). Jezusi a.s. gjithashtu ka qenë i përshkruar si "një njeri i dëftuar nga Perëndia": (Veprat 2:22). Ky ligj është përmendur në Dhjatën e Vjetër: "Perëndia nuk është një njeri, që mund të gënjejë, as edhe bir njeriu që mund të pendohet…" (Numrat 23:19), Perëndia nuk është një njeri: (1 i Samuelit 15:29), (Osea 11:9).<br>Lutja e Jezusit a.s. nuk ka shkuar e papërgjigjur, por ka ardhur përgjigja përmes engjëllit, i cili është shfaqur për t'i dhënë forcë atij: (Luka 22:43).<br>Jezu Krishti (Isai) a.s. e ka përmbushur këtë ligj, ai ka deklaruar se është i dërguar dhe profet i Zotit (Perëndisë). |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët besojnë se Jezusi është anëtar i dytë i Zotit Trinjësor, bir i pjesës së parë të Zotit Trinjësor dhe në të njëjtën kohë "plotësisht" Perëndi në çdo aspekt. Të krishterët besojnë se Jezusi është "Hyjnor" dhe Zot i mishëruar, posedon dy natyra, hyjnore dhe njerëzore në të njëjtën kohë. Këndvështrimi i të krishterëve është se ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njeriut duhet të jetë me të dy natyrat, njeri dhe hyjni, e jo vetëm njeri siç është cituar në: (1 e Timoteut 2:5).<br><br>Shumica e të krishterëve nuk besojnë se Jezusi a.s. ka qenë vetëm një i | Myslimanët flasin për të dy, si për Jezusin (Isain) a.s. ashtu edhe për nënën e tij virgjëreshën Mari (Merjem) me nderim dhe respekt. Myslimanët besojnë se Zoti i Plotfuqishëm nuk u ka zbritur shpallje vetëm Abrahamit (Ibrahimit) a.s. dhe Moisiut (Musait) a.s., por gjithashtu edhe Jezusit (Isait) a.s. dhe profetëve të tjerë. Myslimanët besojnë se Jezusi a.s. është një nga të dërguarit e shenjtë të Perëndisë, ai posedonte dituri dhe urtësi, ishte i bekuar, i lindur pa baba si Adami (Ademi) a.s. Lindja e mbinatyrshme e Jezusit a.s. nuk e bën atë një Perëndi të plotë, ose një bir i Perëndisë ose një |

| | |
|---|---|
| dërguar, një profet, një shërbëtor i Perëndisë dhe vetëm një qenie njerëzore siç është pohuar nga vetë Jezusi a.s. Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | bir "i vetëmlindur" i Perëndisë. Kur'ani e quan Jezusin a.s. se është Fjala e Zotit "Bëhu", kjo nuk do të thotë se Jezusi është Zot ose bir i Zotit. Kur'ani Fisnik: (112:1-4), (5:73), (2:45), (2:48), 19:31-33). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 9- Nënshtrimi ndaj vullnetit të Zotit të Plotfuqishëm (Islam)<br><br> | Jezusi a.s. ia ka nënshtruar veten vullnetit të Zotit të Plotfuqishëm: (Luka 22:42), (Mateu 26:39), (Marku 14:36). Përkthimi më i vjetër i Biblës ishte në gjuhën greke, nënshtrimi ndaj Zotit është përmendur në: (Jakobi 4:7), në gjuhën e vjetër greke: (Ὑποτάγητε οὖν τῷ Θεῷ) dhe në gjuhën moderne greke: (Υποταχθείτε, λοιπόν, στον Θεό), përkthimi në anglisht: Nënshtoje veten, pra ndaj Perëndisë, d.m.th. "bëhu një mysliman".<br><br>Jezusi a.s. e ka adhuruar Zotin e Plotfuqishëm: (Luka 5:16), (Mateu 26:39), (Mateu 26:42), (Mateu 26:44). Jezusi a.s. i është lutur dhe ka kërkuar ndihmë nga Zoti i Plotfuqishëm, madje edhe kur e ringjalli Llazarin: (Gjoni 11:41-43). Jezusi gjithmonë ka shprehur nënshtrimin e tij ndaj Zotit të Plotfuqishëm: (Gjoni 5:30), (Gjoni 14:31). Jezu Krishti a.s. e ka përmbushur këtë ligj, ai ia ka nënshtruar veten Perëndisë, d.m.th. Jezusi a.s. e ka deklaruar Islamin e tij. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët kanë deklaruar besnikërinë e tyre ndaj Jezusit.<br>Të krishterët besojnë se nuk mund të arrihet te Zoti përveçse me anë të Jezusit.<br>d.m.th. të krishterët ia nënshtrojnë vullnetet e tyre Jezusit.<br>Të krishterët injorojnë faktin se Jezusi a.s. ka shprehur nënshtrimin e tij ndaj Zotit të Plotfuqishëm dhe ia ka nënshtruar tërë vullnetin e tij Zotit të Plotfuqishëm.<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët besojnë se të gjithë profetët që nga fillimi i krijimit ishin myslimanë: (Noeu-Nuhu, Abrahami-Ibrahimi, Jakobi-Jakubi, Loti-Luti, Jozefi-Jusufi, Moisiu-Musai, Solomoni-Sulejmani, Jezusi-Isai) dhe profeti i fundit Muhamedi (paqja qoftë mbi të), sepse ata kanë predikuar të njëjtin mesazh, feja e tyre ka qenë: "Nënshtrimi ndaj vullnetit të Zotit të Plotfuqishëm", d.m.th. ata e kanë deklaruar Islamin e tyre.<br>Kur'ani Fisnik: (10:72), (2:128, 132-133), (51:31-36), (12:101), (5:3, 44), (27:30-31, 38, 42, 44), (3:19-20, 52, 83), (40:66). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 10- Emri i Zotit të Plotfuqishëm  | Jezusi a.s. e ka folur gjuhën aramaike,emri i Perëendisë në gjuhën aramaike shkrimin standard është (ܐܠܗܐ), në shkrimin Estrangela është (ܐܠܗܐ) dhe lexohet Alah, në gjuhën arabe emri i Perëndisë është (الله) dhe lexohet Allah. Në gjuhën hebraike, një nga fjalët themelore në hebraisht për Perëndinë është (אלֹה) dhe lexohet Eloh, e që mund lehtë të shqiptohet Alah pa shenjat diakritike, prapashtesa “im” e fjalës (אֱלֹהִים) “Eloh-im” në shumësin e respektit në Biblën hebraike: (Zanafilla 1:1). Sipas Biblës, Jezusi a.s. i ka përdorur këto dy fjalë: ELI: (Mateu 27:46) dhe ELOI: (Marku 15:34), këto dy fjalë ELI dhe ELOI janë të nxjerrura nga fjala Eloh (אֱלֹהַי) në hebraisht, Elah ose Allah në arabisht dhe nuk tingëllon në “Iehova”. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Emri i Perëndisë për të krishterët arabë është Allah.<br><br>Të krishterët nuk i përdorin këto emra: Eloh (אֱלֹהַי) ose Eli ose Eloi ose Allah (الله) si emra të Zotit të Plotfuqishëm.<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin rrugën e Jezusit a.s. | Myslimanët e adhurojnë të njëjtin Zot të Plotfuqishëm të profetëve siç janë Noeu (Nuhu), Abrahami (Ibrahimi), Moisiu (Musai), Davidi (Davudi) dhe Jezusi (Isai) [paqja qoftë mbi të gjithë ata].<br><br>Emri i Zotit të Plotfuqishëm është Allah.<br>Kur’ani Fisnik: (2:255), (59:22-24), (112:1-4). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 11- Monoteizmi  | Asnjë prej profetëve të mëparshëm nuk e ka mësuar doktrinën e Trinitetit. Përkundrazi, ata shpallën njëshmërinë e Zotit. Në (Eksodi 20:3) citohet: "Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje." Citimet nga ana e Zotit janë të thjeshta, të qarta dhe pa kontradiktë dhe konfuzion. "Unë jam Zoti, Perëndia yt." <br>Të gjithë profetët e mëparshëm të dërguar nga Zoti i Plotfuqishëm kanë thirrur në monoteizëm, Moisiu (Musa) a.s.: (Eksodi 3:14-15), (Eksodi 20:2), (Zanafilla 17:1), (Eksodi 20:3-5), (Levitiku 19:3-4), (Ligji i Përtërirë 6:13), (Eksodi 18:11), (Ligji i Përtërirë 45:23). Davidi (Davudi) a.s.: (Psalmet 83:18, 104:1, 105:7, 118:27, 118:28), Solomoni (Sulejmani) a.s.: (Fjalët e urta 9:10), (Predikuesi 12:13), Isaia a.s.: (Isaia 45:19, 43:10-11, 44:6, 45:21-23, 40:28). "Ti nuk mund të shikosh fytyrën time, sepse asnjë njeri nuk mund të më shikojë dhe të jetojë." (Eksodi 33:20). "Perëndia nuk është një njeri, që mund të gënjejë, as edhe bir njeriu që mund të pendohet…" (Numrat 23:19), Perëndia nuk është një njeri: (1 i Samuelit 15:29), (Osea 11:9). <br><br>Jezusi a.s. ka thënë: "Urdhërimi i parë i të gjithëve është: "Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot." (Marku 12:29). Jezusi kurrë nuk ka thënë se unë jam Perëndia, më adhuroni mua. Ai a.s. i ka thirrur njerëzit që t'i luten, ta adhurojnë dhe t'i shërbejnë vetëm Zotit: (Marku 14:32), (Luka 5:16), (Gjoni 17:3), (Mateu 4:10), (Luka 4:8), (Marku 12:28-29). Jezusi a.s. ka thënë se askush nuk është i mirë përveç të vetmi Perëndisë: (Luka 18:18-19), (Marku 10:18), (Mateu 19:17). Askush nuk mund ta shohë Perëndinë, as që mund ta dëgjojë zërin e Tij: (Gjoni 5:37). Harmonizimi i vullnetit të Perëndisë është ritheksuar: (Jakobi 4:12). Perëndia nuk ndryshon (Jakobi 1:17). Dishepujt e Jezusit a.s. i kanë pranuar këto mësime dhe kanë patur besim në një Zot të vërtetë. Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur ligjin për Njëshmërinë e Zotit "Ligjin e Monoteizmit". |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët e shkelin ligjin e parë të urdhërimit duke e adhuruar Jezusin si Zot apo si bir i Zotit.<br>Këshilli i parë i Konstandinopojës ka hartuar një deklaratë dogmatike mbi Trinitetin dhe e ka definuar Frymën e Shenjtë se ka të njëjtën hyjni të shprehur si për Birin nga ana e Këshillit të Nikesë 56 vjet më parë.<br>d.m.th. edhe dy zota janë shtuar Zotit të Plotfuqishëm.<br>1- Zoti Atë = Krijuesi.<br>2- Zoti Birë = Shpëtimtari.<br>3- Zoti Fryma e Shenjtë= Këshilltari.<br><br>Të krishterët janë devijuar larg nga ligji i monoteizmit, ata e kanë ngritur Jezusin a.s. në gradë shumë të lartë, në gradën e Zotit.<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e Monoteizmit të përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët besojnë se të gjithë profetët janë të dërguar nga i njëjti Zoti, Krijuesi, për të përcjellë të njëjtin mesazh: Zoti i vërtetë është vetëm Një, adhuroni vetëm Atë dhe mbahuni urdhërimeve të Tij.<br>Kur'ani Fisnik: (2:136), (7:59), (2:132), (21:25), (27:61), (27:63), (27:64), (1:1-5), (2:225), (5:76), (20:8), (59:23).<br><br>Kur'ani Fisnik, kaptina 112 është theksuar dhe është shpjeguar ligji i Monoteizmit:<br>Thuaj: Ai, All-llahu është Një! (1)<br>All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. (2)<br>As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. (3)<br>Dhe Atij askush nuk i është i barabartë. (4) |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
| --- | --- |
| 12- Bijtë e Zotit (Perëndisë)<br><br><br><br> | Përdorimi i frazës “bijtë e Perëndisë” nuk ka në vete nënkuptimin hyjni dhe kjo ka qenë një frazë e zakonshme në mesin e hebrenjve të cilët e kanë quajtur veten “fëmijë të Perëndisë” ose “bijë të Perëndisë”. Fraza “bir i Perëndisë” në Bibël nuk është i kufizuar vetëm në Jezusin. Bibla na ka treguar se Perëndia ka shumë bijë! Jakobi: (Eksodi 4:22), Solomoni: ( 2 i Samuelit 7:13-14), Efraimi: (Jeremia 31:9), Adami: (Luka 3:38), madje edhe njerëzit e thjeshtë janë quajtur “bijtë e Perëndisë”: (Ligji i Përtërirë 14:1), (Zanafilla 6:2), (Zanafilla 6:4), (Psalmet 29:1), (Jobi 38:7), (Jobi 2:1), (Jobi 1:6).<br>Jezusi a.s. ka folur për “pajtuesit (ndërmjetësuesit)” si “bijtë e Perëndisë”. Në traditën çifute, çdo person i cili e ndjek vullnetin e Perëndisë është quajtur “bir i Perëndisë”: (Zanafilla 6:2,4), (Eksodi 4:22), (Jeremia 31:9), (Psalmet 2:7), (Luka 3:38), (Romakëve 8:14), (Gjoni 6:35), që d.m.th. nëse Jezusi ka thënë në Bibël se ai është “bir i Zotit (Perëndisë)”, kjo nuk e ngre atë në gradën e Zotit të Plotfuqishëm.<br>Jezusi a.s. kurrë nuk ka thënë “Unë jam Perëndi, më adhuroni mua”. Ai a.s. me kujdes i ka ndjekur profetët e mëhershëm dhe e ka përmbushur këtë ligj. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
| --- | --- |
| Të krishterët e adhurojnë Jezusin, Birin e pjesës së parë të Zotit Trinjësor, ata e konsiderojnë Jezusin a.s. “plotësisht” Perëndi në çdo aspekt.<br><br>Jezusi a.s. e ka përgënjeshtruar vetë mashtrimin e Trinitetit dhe kurrë nuk e ka lëvduar atë në Bibël. Madje edhe ai e ka adhuruar vetë Zotin e Plotfuqishëm!<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Zoti i Plotfuqishëm (Allahu) nuk ka lindur asnjë djalë, asnjë vajzë, e as që ka patur grua. Zoti i Plotfuqishëm nuk ka nevojë për një birë e as për një grua që t’i ndihmojë Atij në ndonjë gjë. Ai është Absoluti, Një, Sunduesi i përjetshëm.<br><br>Zoti i Plotfuqishëm e ka korrigjuar keqkuptimin e të krishterëve dhe hebrenjve në lidhje me frazën “Bir i Perëndisë”.<br>“E ata thanë: “I Gjithëmëshirshmi ka fëmijë!” Larg saj qoftë madhëria e Tij! Ja, ata janë robër të ndershëm!” (Kur’ani Fisnik, 21:26) |

| | |
| --- | --- |
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 13- Shpëtimi<br>&<br>Shpëtimtari<br> | Të falurit e mëkateve është çështje që i përket dhe i përkufizohet vetëm Zotit të Plotfuqishëm: (Isaia 43:25), (Isaia 44:22), (Isaia 33:22), (Isaia 64:9), (Jeremia 31:34), (Ezekieli 18:22), (Ezekieli 33:16), (Mikea 7:18), (Mikea 7:19). Zoti i Plotfuqishëm është i vetmi Shpëtimtar: (Juda 1:25), (Ligji i Përtërirë 32:15), (2 i Samuelit 22:3), (2 i Samuelit 22:47), (1 i Kronikave 16:35), (Psalmet 17:7), (Psalmet 18:46), (Psalmet 24:5), (Psalmet 25:5), (Psalmet 27:9), (Psalmet 38:22), (Psalmet 42:5), (Psalmet 42:11), (Psalmet 43:5), (Psalmet 65:5), (Psalmet 68:19), (Psalmet 79:9), (Psalmet 85:4), (Psalmet 89:26), (Psalmet 106:21), (Isaia 17:10), (Isaia 19:20), (Isaia 43:3), (Isaia 43:11), (Isaia 45:15), (Isaia 45:21-22), (Isaia 49:26), (Isaia 60:16), (Jeremia 14:8), (Osea 13:4), (Mikea 7:7), (Habakuku 3:18). Fraza "Shpëtimtar" në Bibël nuk është i përkufizuar vetëm Jezusit a.s. Bibla na ka treguar neve se edhe disa individëve të tjerë u është dhënë ky titull "Shpëtimtar" pa mos qenë i konsideruar Zot!<br>Jehohazi, bir i Jehut: (2 i Mbretërve 13:5), Othnieli, bir i Kenazit: (Gjyqtarët 3:9), Ehudi, bir i Gerit: (Gjyqtarët 3:15).<br>Shpëtimi sipas Jezusit a.s. arrihet vetëm me anë të qëndruarit besnik ndaj urdhërimeve të Zotit të Plotfuqishëm: (Mateu 19:16-17).<br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët besojnë në Shpëtimin e tyre me anë të Jezusit, ata besojnë në Hyjninë dhe kruqëzimin e tij dhe se Jezusi e ka blerë (paguar) faljen e tyre kur ai vdiq në kryq.<br>Të krishterët besojnë se Jezusi është Shpëtimtari i tyre dhe do t'i falë gabimet dhe mëkatet e tyre.<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët besojnë se Zoti i Plotfuqishëm (Allahu) është Shpëtimi i tyre, Ai është Shpëtimtari i tyre në këtë botë dhe në ditën e Gjykimit. Myslimanët besojnë se askush nuk është përgjegjës për gabimet e të tjerëve. Kur'ani Fisnik (6:164). Myslimanët gjithashtu besojnë se Zoti i Plotfuqishëm e shpëtoi profetin Jezus a.s. nga kryqëzimi dhe se atë as që e kanë vrarë e as që e kanë kryqëzuar. Kur'ani Fisnik (4:157). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 14- Dituria absolute (Gjithëdijenia)  | Jezusi a.s. e ka mohuar “gjithëdijeninë” për njohuritë e të fshehtës dhe ditës së Gjykimit: (Marku 13:32), (Mateu 24:36). |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët ia atribuojnë “gjithëdijeninë” Jezusit. Jezusi a.s. e mohoi “gjithëdijeninë” e tij. Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Zoti i Plotfuqishëm ka njohuri të përkryer (absolute). Myslimanët besojnë në Gjithëdijeninë e Allahut, Ai e di të kaluarën dhe të ardhmen. Kur’ani Fisnik (49:18) |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 15- Mrekullitë (mu'xhizet)<br> | Jezusi a.s. dhe profetët e mëhershëm kanë bërë mrekulli (mu'xhize) të ndryshme mbresëlënëse, këto ngjarje të jashtëzakonshme janë bërë vetëm me lejen e Zotit të Plotfuqishëm. Moisiu a.s.: (Eksodi 14:22), Eliseu a.s.: (2 i Mbretërve 4:44), (2 i Mbretërve 5:14), (2 i Mbretërve 6:17&20), (2 i Mbretërve 4:34), (2 i Mbretërve 13:21), Elia a.s.: (1 i Mbretërve 17:22), Jezusi a.s.: (Luka 9:10-17), (Gjoni 6:16-24), (Marku 6:45-52), (Mateu 14:22-33).<br><br>Jezusi a.s. nuk ka vepruar nga vetja e tij, ai ka thënë në (Gjoni 5:30): "Unë s`mund të bëj asgjë nga vetja ime; gjykoj sipas asaj që dëgjoj dhe gjyqi im është i drejtë, sepse nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e Atit që më ka dërguar." Gjithashtu në (Gjoni 8:28): "...nuk bëj asgjë prej vetvetes, por i them këto gjëra ashtu si Ati më ka mësuar." Nga këto versete nuk nënkuptojmë plotfuqishmërinë. Jezusi a.s. e ka zvogëluar veten dhe e ka ulur atë përpara Zotit të Plotfuqishëm.<br><br>Jezusi a.s. e ka përmbushur këtë ligj. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët i konsiderojnë mrekullitë mbresëlënëse që i kanë bërë profetët e mëparshëm si dëshmi për Profetësinë e tyre dhe besojnë se kanë ndodhur me lejen e Zotit të Plotfuqishëm, ndërkohë që ata i konsiderojnë mrekullitë mbresëlënëse që i ka bërë Jezusi a.s. si dëshmi për Hyjninë e tij.<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët besojnë se Zoti i Plotfuqishëm i ka mbështetur profetët e tij si: Abrahamin, Moisiun, Davidin, Solomonin, Jezusin dhe Muhamedin (paqja qoftë mbi ta) me mrekulli të cilat zakonisht janë të natyrës së njëjtë që i dallon profetët e veçantë nga njerëzit, ku këto mrekulli janë bërë vetëm me lejen e Zotit të Plotfuqishëm. Në Kur'anin Fisnik emri i Jezusit (Isait) a.s. haset në 25 vende, emri i nënës së tij Virgjëreshës Mari (Merjem) haset në 34 vende, ndërsa emri i Muhamedit a.s. haset në 3 vende. |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 16- Përshëndetjet  | Davidi a.s. i ka përshëndetur njerëzit duke thënë "Shalom aleichem", që do të thotë në gjuhën hebraike "Paqja qoftë mbi ty": (1 i Samuelit 25:6).<br>Jezusi a.s. e ka ndjekur këtë traditë dhe poashtu ka përshëndetur në të njëjtën mënyrë duke thënë "Paqja qoftë mbi ty": (Gjoni 20:19), (Gjoni 20:21), (Gjoni 20:26), (Luka 24:36).<br>Jezusi a.s. e ka përmbushur këtë traditë. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët nuk e përshëndesin njëri-tjetrin duke thënë "Paqja qoftë mbi ju". Të krishterët nuk e ndjekin këtë traditë të përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët e përshëndesin njëri-tjetrin duke thënë: "es-selamu alejkum", që do të thotë në gjuhën arabe "Paqja qoftë mbi ju". Kur'ani Fisnik (6:54), (7:46), (11:48), (13:24), (39:73), (11:69), (14:23), (36:58), (97:5). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 17- Pijet alkoolike  | Profetët e mëhershëm kanë hequr dorë nga pijet alkoolike. Moisiu a.s.: (Numrat 6:1-4), Solomoni a.s.: (Fjalët e urta 20:1).<br><br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj.<br><br>Lidhur me “mrekullitë e shndërrimit të ujit në verë” është gjetur vetëm në Ungjillin (Gjoni 2:1-11), e cila vazhdimisht bie ndesh me tre Ungjijtë tjerë. Dijetarët e Dhjatës së Re kanë shprehur dyshime në lidhje me vërtetësinë e kësaj ngjarjeje. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Shumë të krishterë pijnë lloje të ndryshme të pijeve alkoolike, ata e injorojnë një pjesë të fjalës së Zotit në supozimin se jo e gjithë kjo vlen për ta. Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Është një njohuri e zakonshme në mesin e myslimanëve se pijet alkoolike janë absolutisht të ndaluara, sepse ndikojnë negativisht në lidhjen e tyre me Zotin e Plotfuqishëm dhe mund të çojë edhe në shumë gjëra negative, si shëndetësia dhe problemet sociale. Kur’ani Fisnik (5:90). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 18- Mishi i derrit  | Moisiu a.s. nuk e ka ngrënë mishin e derrit pas ndalimit të përmendur në: (Levitiku 11:7-8) dhe (Ligji i Përtërirë 14:8).<br><br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj: (Mateu 5:17-18), (Luka 24:44). |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Shumë të krishterë e hanë mishin e derrit, ata e injorojnë pjesët e fjalës së Zotit kur flet në lidhje me këtë, në supozimin se jo e gjithë kjo vlen për ta. Dijetarët e krishterë i interpretojnë deklarimet e Paulinit dhe diskutimin rreth vegjetarianizmit në (Romakëve 14:2-3) derisa të jepet leja për të ngrënë ndytësitë rituale.<br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët nuk e hanë mishin e derrit dhe produktet e tij, sepse është i ndaluar.<br>Kur'ani Fisnik (5:3), (2:173). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

<table>
<tr><td>Krahasim</td><td>Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre.</td></tr>
<tr><td>19- Therja e kafshëve<br></td><td>Termi në hebraisht “Shechita” është therje rituale e gjitarëve dhe zogjve sipas ligjeve hebreje dietike: (Ligji i Përtërirë 12:21), (Ligji i Përtërirë 14:21), (Numrat 11:22).<br>Therësi i kryen ritualet me bekimin e Zotit dhe e përmend vetëm emrin e Zotit, Sunduesit të universit, nuk shqiptohen emra të udhujve. Kafshët duhet të rrëzohen (për therje) “me respekt dhe dhembshuri” nga ana e një therësi ritual, akti kryhet me prerjen e trakesë, ezofagut, arterieve karotide, venëve të qafës me një veprim të shpejtë duke përdorur një thikë shumë të mprehtë. Kjo rezulton në një rënie të menjëhershme të presionit të gjakut në tru dhe humbje të pakthyeshme të vetëdijes. Në fund të procesit të therjes, mishi bëhet i përshtatshëm për konsumim, i quajtur në gjuhën hebraike “Kosher”.<br><br>Kjo është e cituar në Veprat e Apostujve 15:20: “Por t`u shkruhet atyre që të heqin dorë...nga gjërat e mbytura dhe nga gjaku.” Jezusi a.s. me kujdes i ka ndjekur dhe i ka përmbushur këto rregulla të therjes.<br><br>A është therja mizore?<br>Ky pretendim ka qenë i shqyrtuar nëpërmjet të përdorimit të inçizimeve EEG dhe EKG gjatë therjes.</td></tr>
</table>

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët para therjes përmendin emrin e Zotit (Perëndisë) në Trininë e Shenjtë, të tjerët përmendin emrin e Jezu Krishtit si një anëtar i dytë i Perëndisë Trinjësore, të tjerët nuk përmendin ndonjë emër. Disa kompani për therje i mbysin kafshët që të mbetet gjaku në mish, ky veprim ka qenë i ndaluar në (Veprat e Apostujve 15:20), disa kompani të tjera i vrasin kafshët me anë të pistoletës me bulona ose me anë të goditjes së fortë elektrike e cila shkakton trullosjen e kafshëve.<br>Shënimet EEG kanë treguar dhimbje të forta. Të krishterët nuk i ndjekin rregullat e therjes të cilat janë të | Ka shumë kushte për metodën islame në therje (Dhabiha), kushtet kryesore janë si vijon: 1) Therësi duhet të jetë mysliman. 2) Marrja e “Tekbirit” (përmendja e Allahut) në kohën e therjes së kafshës, pra duke thënë “Allahu Ekber” që do të thotë Zoti i Plotfuqishëm (Allahu) është më i Madhi. 3) Prerja e fytit (kanalit të ushqimit), laringut (kanalit të frymëmarrjes) dhe venave të qafës. Mishi bëhet i freskët për një kohë më të gjatë për shkak që gjaku të mënjanohet dhe mishit të jetë i ligjshëm për konsumim, që në arabisht quhet “Hallall”. |

| | |
|---|---|
| përmendura në Biblën e tyre.<br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | EEG-ja ka inçizuar një zero shënim, duke mos treguar asnjëfarë dhimbje.<br><br>Kurani Fisnik (22:34), (6:121), (5:3), (2:173). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 20- Ngrënia e mishit me gjak  | Profetët e mëhershëm e kanë udhëzuar popullatën e tyre që të mos hanë mish me gjithë gjakun në të, Noeu (Nuhu) a.s.: (Zanafilla 9:3-4), Moisiu (Musa) a.s.: (Levitiku 19:26), (Levitiku 17:10-14), (Ligji i Përtërirë 12:16,23).<br><br>Kjo është e cituar në Veprat e Apostujve 15:20: “Por t`u shkruhet atyre që të heqin dorë...nga gjërat e mbytura dhe nga gjaku.”<br><br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Të krishterët mund të hanë mishin me gjakun në të (shembull: biftekët e pazakonshëm), megjithatë kjo ka qenë e ndaluar në (Veprat e Apostujve 15:20), (Veprat e Apostujve 15:29). Të krishterët besojnë se ky rregull është liruar nga kishat e mëhershme. Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Në Islam është e ndaluar ngrënia e mishit që përmban gjak në të. Kur’ani Fisnik (6:145), (2:173), (5:3). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 21- Gratë e mbuluara me perçe (vello)<br> | Gratë e mbuluara me perçe (vello) kanë jetuar në kohën e Jezusit a.s. si dhe në kohët e profetëve të mëhershëm. (Zanafilla 24:64-65), (1 e Korintasve 11:5-6).<br>Jezusi a.s. kurrë nuk e ka konsideruar perçen (vellon) si një ritual të vjetër apo një normë kulturore e cila më nuk është e detyrueshme.<br><br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj: (Mateu 5:17-18), (Luka 24:44). |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Në ditët e sotme shumica e grave krishtere nuk janë të mbuluara me vello, nuk e ruajnë modestinë (thjeshtësinë) e tyre dhe e shfaqin bukurinë e tyre. Velloja shihet si një ritual i vjetër dhe një normë kulturore e cila më nuk është e detyrueshme.<br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Shumica e grave myslimane janë të mbuluara me vello, e ruajnë modestinë (thjeshtësinë) e tyre, nuk e shfaqin bukurinë e tyre.<br>Kur'ani Fisnik (24:31), (33:59). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 22- Pastërtia, Larja e tërë trupit  | Moisiu (Musa) a.s. i ka urdhëruar ligjet në (Levitiku 11), (Levitiku 12) dhe (Ligji i Përtërirë 14). Për pastërti (tohoRAH) / papastërti (tumAH).<br><br>Davidi (Davudi) a.s. <u>është larë</u> që të jetë i pastër, ka shkuar në shtëpinë e Zotit dhe e ka adhuruar: (2 i Samuelit 12:20), Eliseu a.s.: (2 i Mbretërve 5:10,14).<br><br>Jezusi a.s. nuk e ka shfuqizuar apo kundërshtuar ligjin e pastërtisë / papastërtisë. Jezusi a.s. është përgjigjur, "Ai që është <u>i larë</u>, s`ka nevojë <u>veçse</u> të lajë këmbët dhe <u>është krejt i pastër</u>; edhe ju jeni të pastër, …" (Gjoni 13:10).<br>Jezusi a.s. nuk ka kundërshtuar asnjë rregullore të papastërsisë rituale të kohës. Dhjata e Re tregon se praktika e larjes së trupit (pastërtia ritual dhe ngjashëm me atë ana shpirtërore, morale dhe etike) me ujë të pastër ka vazhduar nga pasuesit e Jezusit a.s.: (Hebrenjve 10:22).<br><br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe <u>e ka përmbushur</u> këtë ligj. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Ditëve të sotme shumë të krishterë nuk e ndjekin ligjet e Levitikut për pastërtinë / papastërtinë. <u>Për shembull</u>: burrat dhe gratë e tyre pas marrëdhënies së tyre intime, burrat pas ejakulimit të spermës, gratë në ciklin e tyre menstrual mund të hyjnë në kishat dhe të luten normalisht pa e larë trupin e tyre për mbajtje të pastërtisë. Ky veprim është bazuar në Letrat e Palit: (1 e Thesalonikasve 5:16-18) "Lutuni pa pushim". Megjithatë, ky verset thjeshtë do të thotë "gjithmonë kujtojeni Perëndinë", <u>nuk</u> do të thotë "Lutuni gjatë kohës kur jeni të pastër dhe / ose të papastër"!<br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin <u>e përmbushur</u> nga Jezusi a.s. | Ka shumë norma islame për pastërtinë (tahareh) / papastërtinë (nexhaseh). <u>Për shembull</u>: burrat dhe gratë e tyre pas marrëdhënies së tyre intime, burrat pas ejakulimit të spermës, gratë në ciklin e tyre menstrual nuk mund të hyjnë në xhami dhe nuk mund të falen derisa ata të pastrohen plotësisht dhe të lajnë tërë trupin e tyre për pastërti. Në Islam mensturacionet nuk janë as "mallkim" e as rezultat i të ashtuquajturit mëkati i parë i Evës. Kur'ani Fisnik (2:22). Islami ka ofruar <u>udhëzim hyjnor</u> nga të dy, Zoti i Plotëfuqishëm (Allahu) dhe profeti Muhamed a.s. me anë të cilës secili person do të mund "ta kujtojë gjithmonë Zotin". |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 23- Poligamia  | Martesat poligame kanë ndodhur në mesin e të gjithë profetëve përpara Jezusit a.s. Abrahami (Ibrahimi) a.s. ka pasur tri gra: (Zanafilla 25:1) dhe konkubinat: (Zanafilla 25:6). Jakobi (Jakubi) a.s. ka pasur 2 gra dhe 2 konkubina: (Zanafilla 30:3,9). Moisiu (Musai) a.s. ka pasur 2 gra: (Eksodi 2:21), (Eksodi 18:1-6), (Numrat 12:1). Davidi (Davudi) a.s. ka pasur tetë gra të cilat janë të përmendura në Bibël, por ka pasur shumë gra të tjera që nuk janë përmendur dhe më shumë se dhjetë konkubina: (1 i Kronikave 3:1-9), (2 i Samuelit 15:16), (2 i Samuelit 16:21-22), (2 i Samuelit 20:3). Solomoni (Sulejmani) a.s. pa pasur 700 gra, princesha dhe 300 konkubina (1 i Mbretërve 11:3).<br><br>Jezusi kurrë nuk e ka kundërshtuar apo diskutuar çështjen e zvogëlimit të numrit të grave dhe të konkubinave. Jezusi a.s. e ka ndjekur dhe <u>e ka përmbushur</u> këtë ligj. Sipas të At Eugene Hillman, Kisha në Romë e ka ndaluar poligaminë në mënyrë që të jenë në përputhje me kulturën greko-romake e cila e ka përcaktuar vetëm një grua ligjore ndërsa toleron bashkëjetesë jashtë martese dhe prostitucion. (Rishqyrtimi i poligamisë, fq. 140). |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Shumë të krishterë bëjnë një shfaqje të madhe të monogamisë, por në fakt ata praktikojnë poligaminë, siç janë dashnoret. Tani është shumë e zakonshme të gjeni në shoqëritë krishtere marrëdhënie seksuale jashtë martesës, marrëdhëniet e paligjshme sekrete & tradhti bashkëshortore.<br><br>Problemi i raporteve seksuale të pabalancuara bëhet problem gjatë kohëve të luftës. Poligamia vazhdon të jetë një zgjidhje praktike për disa prej sëmundjeve sociale të shoqërive moderne. Të krishterët nuk e ndjekin ligjin <u>e përmbushur</u> nga Jezusi. | Islami e ka lejuar poligaminë si një zgjidhje për sëmundjet shoqërore dhe ka lejuar një nivel të caktuar të lirisë për natyrën njerëzore, por vetëmse në brenda një kornize të ligjit të caktuar në mënyrë të përpiktë, (maksimum katër gra në të njëjtën kohë) dhe ka përcaktuar mbajtjen e drejtësisë si një kusht themelor për poligaminë.<br><br>Kur'ani Fisnik (4:3) |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 24- Përkulja para idhujve, figurave të gdhendura, statujave & kryqeve<br><br><br><br><br>Ndikimi pagan ka paraqitur kryqin si një simbol<br><br> | Profetët e mëhershëm (paqja qoftë mbi ta) i kanë ndaluar të gjitha llojet e idhujtarisë siç janë shëmbëlltyrat e gdhendura, skulpturat, ikonat, idhujt, mos ketë figura të ndonjë mashkulli apo femre brenda faltoreve dhe tempujve të tyre, si dhe e kanë ndaluar të përkulurit përpara tyre. Zoti i Plotfuqishëm e ka quajtur veten "një Perëndi xheloz". Moisiu (Musai) a.s.: (Eksodi 23:24), (Eksodi 20:4-5), (Eksodi 34:7), (Eksodi 34:14), (Ligji i Përtërirë 5:6-9), (Ligji i Përtërirë 4:24), (Ligji i Përtërirë 5:9), Davidi (Davudi) a.s.: (Psalmet 94:1), Jozueu a.s.: (Jozueu 23:7), (Jozueu 24:19), Elia a.s.: (1 i Mbretërve 19:10), Ezekieli a.s.: (Ezekieli 20:7), (Ezekieli 39:25), Nahumi: (Nahumi 1:2).<br><br>Profetët e mëhershëm (paqja qoftë mbi ta) e kanë ndaluar të përkulurit përpara shëmbëlltyrave të gdhendura apo idhujve që u rrijnë në shërbim. Moisiu a.s.: (Eksodi 20:3-5), (Ligji i Përtërirë 4:15-19), (Levitiku 26:1), (Eksodi 32:7-8), Davidi a.s.: (Psalmet 135:15-18), Isaia a.s.: (Isaia 44:9), (Isaia 2:17-18) dhe Ezekieli: (Ezekieli 30:13).<br><br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj: (Mateu 5:17-18), (Luka 24:44), (1 e Gjonit 5:21), (Veprat e Apostujve 17:28-29), (Zbulesa 2:14), (Zbulesa 2:20), (Zbulesa 21:8), (Zbulesa 22:15).<br><br>N.B. Forma e Kryqit e ka origjinën e vet nga Kaldea e lashtë, ajo është përdorur si simbol i Tammuz (T-ja është iniciali i emrit të tij) … Në mënyrë që të rrisin prestigjin e paganëve femohues klerikal, i kanë pranuar në kisha larg nga rigjenerimi nëpërmjet besimit dhe në përmasa të mëdha i kanë lejuar të mbajnë shenjat dhe simbolet e tyre pagane. Prandaj T-ja në formën e tij më të shpeshtë, me copën e tërthortë të kryqit teposhtë është aprovuar që të vendoset për "kryqin" e Krishtit. (Vine's Expository Dictionary of Neë Testament Ëords, Copyright © 1985, Thomas Nelson Publishers). Pra, siç tregohet më sipër, ndikimi pagan dalëngadalë e ka futur kryqin si një simbol, i cili më vonë u bë i aprovuar nga ana e greko-romakëve. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Kishat kanë shumë lloje të idhujve, siç janë: pikturat, shëmbëlltyrat e gdhendura të Zotit, statujat e Nënës së bekuar Mari, Engjëjve, Jezusit a.s. varur në kryq dhe ikonat e shenjtorëve, figurat e gdhendura, shëmbëlltyrat e meshkujve dhe femrave, pëllumbave, peshqive…etj. Të krishterët gjunjëzohen përpara kryqit, ata përkulen para shëmbëlltyrave dhe statujave që i kanë bërë njerëzit dhe u shërbejnë atyre. Disa të krishterë vendosin kryqa si "një simbol i besimeve të tyre". Të krishterët e shkelin urdhërin e dytë Hyjnor të Dhjetë Urdhërimeve: (Eksodi 20:3-5) Të krishterët nuk e ndjekin këtë ligj të përmbushur nga Jezusi a.s. | Në Islam nuk është e lejueshme të lutesh në një dhomë në të cilën janë të varura statujat apo shëmbëlltyrat e qenieve të gjalla. Ka disa thënie (hadithe) të Profetit a.s. si në vijim:<br>1- "Engjëjt nuk hyjnë në një shtëpi në të cilën ka qen dhe shëmbëlltyra."(E rënë dakort-Buhari/Muslim).<br>2- "Njerëzit të cilët do të jenë të dënuar më rëndë në ditën e Kijametit do të jenë ata të cilët e imitojnë (kopjojnë) krijimin e Zotit." (E rënë dakort-Buhari/Muslim)<br><br>Profeti Muhamed a.s. i shkatërroi 360 idhuj përreth Qabesë që i kanë adhuruar njerëzit para Islamit. |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 25- Tradhëtia bashkëshortore<br><br> | Është e cituar në (Hebrenjve 13:4) se martesa duhet të nderohet nga të gjithë dhe të mbahet pastër (i papërlyer) shtrati martesor, sepse Perëndia do t'i gjykojë kurorëshkelësit dhe të gjithë që bëjnë imoralitet seksual. Tradhëtia bashkëshortore është e ndaluar "Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore." (Tradhëtia bashkëshortore përmendet 49 herë në Bibël në forma të ndryshme). (Eksodi 20:14), (Levitiku 20:10), (Ligji i Përtërirë 5:18), (Psalmet 51:1), (Fjalët e urta 6:32), (Jeremia 3:6), (Jeremia 3:8), (Jeremia 3:9), (Jeremia 5:7), (Jeremia 7:9), (Jeremia 23:14), (Jeremia 29:23), (Ezekieli 16:32), (Ezekieli 16:38), (Ezekieli 23:27), (Ezekieli 23:37), (Ezekieli 23:43), (Ezekieli 23:45), (Osea 1:2), (Osea 2:2), (Osea 2:4), (Osea 4:2), (Osea 4:13), (Osea 4:14), (Osea 4:15), (Osea 7:4), (Mateu 5:27), (Mateu 5:28), (Mateu 5:32), (Mateu 15:19), (Mateu 19:9), (Mateu 19:18), (Marku 7:21), (Marku 10:11), (Marku 10:12), (Marku 10:19), (Luka 16:18), (Luka 18:20), (Gjoni 8:3), (Gjoni 8:4), (Romakëve 2:22), (Romakëve 13:9), (Galatasve 5:19), (Jakobi 2:11), (2 e Pjetrit 2:14), (Zbulesa 17:2), (Zbulesa 18:3), (Zbulesa 18:9).<br>Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Shumë të krishterë besojnë se Perëndia nuk do të kryej gjykimin për shkak se Jezu Krishti është Shpëtimtari i tyre, ata i lejojnë marrëdhëniet seksuale jashtë martesës, kurorëshkeljen, kurvërinë, lidhjet e fshehta me gjininë e kundërt, …etj.<br><br>Shumë të krishterë kanë harruar se tradhëtia bashkëshortore është një mëkat ndaj Perëndisë dhe se ata nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Myslimanët janë shumë të interesuar me lakmi për të bërë martesë islame, sepse Islami nuk lejon marrëdhëniet seksuale jashtë martese, kurorëshkeljen, kurvërinë, …etj. Këto konsiderohen si mëkate të mëdha.<br><br>Kur'ani Fisnik (24:3-4), (17:32), (7:33), (24:26). |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 26- Pastërtia, Synetimi  | Rrethprerja (synetimi) nuk është i bazuar në legjislacionin e Mozaikut porn ë besëlidhjen e Abrahamit: (Zanafilla 12:1-3). Profeti Abraham dhe pasardhësit e tij ishin të synetuar-rrethprerë (bësëlidhja e përjetshme): (Zanafilla 17:1-2). Neglizhimi për të qenë rrethprerë paraqet thyerje të besëlidhjes me Perëndinë: (Zanafilla 17:14). Rrethprerja (synetimi)nuk është një parakusht absolut për pjesëmarrje në kremtimin e Pashkëve: (Eksodi 12:44,48). Legjislacioni i përgjithshëm është përsëritur në (Levitiku 12:3). Eksodi 4:26 e ka përmnedur rrethprerjen e djalit të Moisiut. Jozueu 5 ka njoftuar për rrethprerjen para hyrjes në tokën e premtuar. Në Zanafilla 34:15 ka qenë e ndaluar për një kujdestar të pranojë kërkesën për martesë të një gruaje besimtare nga një njeri i parrethprerë.<br><br>Jezusi a.s. e mbajti “besëlidhjen e përjetshme” dhe ka qenë i rrethprerë: (Luka 2:21), (Luka 1:59), (Romakëve 2:29). Jezusi ka folur rreth rrethprerjes (synetisë) tek Gjoni 7:22-23. Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj fetar. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Në përgjithësi, të krishterët meshkuj nuk janë të rrethprerë (synetuar) për shkak të interpretimit të rremë të Palit i cili ka pretenduar se rrethprerja është një çështje e zemrës, nga fryma (shpirti): (Romakëve 2:29). Pali ka thënë se “Në qoftë se rrethpriteni, Krishti nuk do t`ju bëjë dobi aspak”. (Galatasve 5:2), “...cila është dobia e rrethprerjes?...”. (Romakëve 3:1-2). Në 1 e Korintasve 7:18-19 Pali e sjell të njëjtën gjë më shkurtimisht: “Rrethprerja nuk është asgjë”. Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Si një praktikë e përgjithshme të gjithë myslimanët meshkuj janë të rrethprerë (synetuar), sepse kjo ka qenë praktikë e profetit Abraham (Ibrahim) a.s. dhe gjithashtu ka qenë praktikë (Sunnet) i profetit tonë të dashur Muhamedit a.s. |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
| --- | --- |
| 27- Fajdeja (kamata)<br> | Termi biblik për fajden (kamatën) “Neshek” është fort negativ, e që rrjedh nga rrënja kuptimi bazë i të cilit është “të sulmosh si një gjarpër”.<br>Profetët e mëhershëm e kanë kundërshtuar marrjes ose dhënien e fajdes (kamatës): (Ligji i Përtërirë 23:19,20), (Levitiku 25:36-37), (Eksodi 22:25), (Ezekieli 18:8-9), (Ezekieli 18:13), (Ezekieli 18:17), (Ezekieli 22:12), (Psalmet 15:1-5), (Jeremia 15:10).<br><br>Jezusi a.s. e ka kundërshtuar marrjen ose dhënien e fajdes (kamatës): (Mateu 25:27) dhe (Luka 19:22-23). Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj: (Mateu 5:17-18), (Luka 24:44). |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
| --- | --- |
| Në ditët e sotme shumë të krishterë nuk janë të vetëdijshëm se marrja ose dhënia e kamatës është mëkat.<br><br>Të krishterët nuk e ndjekin ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Termi në arabisht për fajden (kamatën) “Riba”, vjen nga rrënja me kuptimin “të rrisësh, të shtojsh”. Myslimanët kanë zhvilluar një sistem alternativ bankarë, zakonisht të njohur si “Sistemi bankarë islam” i cili nuk ka asnjë interes përfitimi me qëllim që të shmangë marrjen ose dhënien e kamatës.<br>Kur’ani Fisnik (2:275), (2:276), (2:278), (3:130), (4:161). |

| | |
| --- | --- |
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

<table>
<tr><th>Krahasim</th><th>Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre.</th></tr>
<tr><td>28- Mjekra dhe veshja (rrobat)<br></td><td>Profetët e mëhershëm kanë pasur mjekërr: (Psalmet 133:2), (Isaia 50:6), (Esdra 9:3). Ligji i Mozaikut e ka ndaluar prerjen e basetave dhe `fundin e mjekrrës`: (Levitiku 19:27), (Levitiku 21:5). Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë ligj.<br><br>Moisiu (Musai) a.s. dhe Aroni (Haruni) kanë veshur rroba të gjata: (Numrat 15:38), (Levitiku 16:23), (Eksodi 29:29), (Eksodi 29:5), (Eksodi 28:2), (Eksodi 31:10).<br>Jezusi a.s. gjithashtu ka veshur rroba të gjata: (Mateu 9:20-22), (Luka 8:43-48) dhe (Marku 6:56). Jezusi a.s. me kujdes e ka ndjekur dhe e ka përmbushur këtë traditë.</td></tr>
</table>

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Është e rrallë ditëve të sotme të gjeni të krishterë të veshur me rroba të gjata, disa i rrisin mjekrrat e tyre si një lloj mode.<br>Të krishterët nuk e ndjekin traditën dhe ligjin e përmbushur nga Jezusi a.s. | Shumë myslimanë janë me mjekër sepse ata e ndjekin praktikën (Sunnetin) e profetit Muhamed a.s.<br>Shumica e myslimanëve janë të veshur në mënyrë modeste dhe shumë prej tyre veshin rroba të gjata. |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 29- Muhammedi është i paralajmëruar në Dhjatën e Vjetër<br><br> | Në “Kënga e Këngëve të Solomonit” (Shir ha-Shirim, 5:16), fjala מַחֲמַדִּים lexohet në formën origjinale si Ma.ha.mad.dim; në gjuhën hebraike ‘im’ është shtuar për të shprehur më shumë respekt, origjina e fjalës מחְמד është prej “hamad” e cila në të dy gjuhët, hebraisht dhe arabisht është folja “lavdëroj, dëshiroj” dhe është rrënja kryesore e fjalës arabe (مُحَمَّدٌ) e cila lexohet si Muhammed. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Çifutët po thonë se kjo fjalë në hebraisht מַחֲמַדִּים flet për Solomonin a.s., përderisa të krishterët thonë se flet për Jezusin a.s. Përkthimi biblik i versetit është siç vijon: "Goja e tij është tepër e ëmbël: po, ai është mjaft i këndshëm. Ky është i dashuri im, dhe ky është miku im, O bijtë e Jeruzalemit." | Përkthimi i saktë për (Kënga e Këngëve, 5:16) duhet të jetë siç vijon: "Goja e tij është tepër e ëmbël: po, ai është Muhammedi. Ky është i dashuri im dhe ky është miku im, o bijtë e Jeruzalemit." |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

| Krahasim | Mënyra që e praktikoi Jezu Krishti (Isai) a.s. Ndjekja e profetëve të mëparshëm dhe Përmbushja e ligjeve të tyre. |
|---|---|
| 30- Myslimanët të përmendur në Bibël<br><br>אֵין תַּלְמִיד נַעֲלֶה עַל רַבּוֹ; שֶׁכֵּן כָּל אָדָם שֶׁמֻּשְׁלָם יִהְיֶה כְּרַבּוֹ. | Emri “Meshullam” në hebraisht מְשֻׁלָּם ishte shumë i zakonshëm në kohën pas dëbimit dhe haset në 25 vende në Bibël. Në (Luka 6:40) të Biblës hebraike, Jezusi a.s. e ka përdorur këtë fjalë שמשלם dhe transliterimi i saj është “She-Mushlam”. Origjina e këtyre dy fjalëve në hebraisht “Meshullam” dhe “Mushlam” është nga “Shalam” שָׁלֵם dhe origjina e kësaj fjale në arabisht مُسْلِم "Mysliman" është nga "Salima" سَلِمَ . Në të dy gjuhët, hebraisht dhe arabisht “Shalam” dhe “Salima”, e kanë të njëjtin kuptim “Të qenit në një marrëveshje për paqe, bindje paqësore, nënshtrim ndaj Zotit, të qenit i plotë (tërësor), zemër të përsosur” ndaj Zotit. Kjo do të thotë se \`Mushlam\` e ka kuptimin \`mysliman\`. |

| Mënyra e të krishterëve | Mënyra e myslimanëve |
|---|---|
| Fjala në hebraisht שמשלם "She-Mushlam" është përkthyer në “i shkëlqyer”.<br>Përkthimet biblike të versetit në (Luka 6:40) është siç vijon: “Dishepulli nuk ia kalon mësuesit të vet, por çdo dishepull që është i shkëlqyer do të jetë si mësuesi i vet.” | Përkthimi i saktë për fjalën në hebraisht שמשלם "She-Mushlam" është \`mysliman\`.<br><br>Përkthimi i saktë për versetin në (Luka 6:40) është siç vijon: “Dishepulli nuk ia kalon mësuesit të vet, por çdo dishepull që është mysliman do të jetë si mësuesi i vet.” |

| | |
|---|---|
| A ishte Jezusi a.s. i krishter? | |
| A ishte Jezusi a.s. mysliman? | ✔ |

## Konkluzioni

Jezusi a.s. i ka ndjekur dhe i ka përmbushur ligjet e profetëve të mëhershëm dhe ka qenë mysliman, feja e tij ka qenë Islami.

Nëse nuk jeni duke ndjekur ligjet e përmbushura nga Jezusi a.s., atëherë përse e quani veten Christ-ian (Të krishterë/ndjekës të Krishtit)? Faktikisht ju duhet ta quani veten Church-ian (Kishtarë/ndjekës të Kishës) ose Paul-ian (Palianë/ndjekës të Palit) ose këdo që e ndiqni.

Nëse jeni të interesuar për të ndjekur rrugën (mënyrën) e myslimanëve, atëherë ju mund të vizitoni faqen tonë të internetit: www.islamic-invitation.com

## Referencat

1- Kur'ani Fisnik
2- Përkthime shumëgjuhëshe të Biblës.
3- Tora (Teurati)
4- Faqet autentike të internetit në religjionet komparative.

Ky studim është © në www.islamic-invitation.com